



Datë: 25.10.2025
Numër Protokolli: 7086/2025

A.nr.675/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi Prenaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.675/2025, të datës 17.04.2025, të parashtruar nga ankuesi E.K, kundër organit të punësimit: Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 25.10.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.675/2025, e datës 17.04.2025, e parashtruar nga ankuesi, E.K.

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër reference DS-163/2025, i datës 26.03.2025, i Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi E.K (*tutje referuar ankuesi*), më datë 16.04.2025, përmes postës së Kosovës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar më datë 17.04.2025 dhe e regjistruar nën shenjë A.nr.675/2025, kundër Vendimit me numër referencës DS-163/2025, të datës 26.03.2025, të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (*tutje referuar SKGJK*), ndërsa, Këshilli më datë 12.06.2025, ka pranuar përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, administroi këto prova: Ankesën me numër 2529/2025, të datës 17.04.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër Nr.57 të datës 23.01.2023; Dëftesën për pranimin e dërgesës të datës 11.03.2025; Dëftesën për pranimin e dërgesës të datës 31.01.2025; Vendimin me numër Nr.502 të datës 26.03.2025; Akt emërimit me numër protokolli Nr.883 të datës 01.07.2024; Akt emërimit Nr.2203 të datës 09.12.2022; Vendimin Nr.04/128 të datës 16.02.2023; Dëshminë për qarkullimin e llogarisë të lëshuar nga Raiffeisen Bank për periudhën 10.03.2023 deri më 01.07.2024; Formularin e parashtrimit të ankesës; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Përgjigjen në ankesë të datës 12.06.2025; Kërkesën e datës 10.03.2025; Kërkesën e datës 31.01.2025; Rregulloren nr.02/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës për Nëpunësit Civil në Administratën e Sistemit Gjyqësor; Listat e pagave 2023 dhe 2024; Vendimin e Kryetarit të Këshillit.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e pabazuar, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesi fillimisht sipas Akt Emërimit me numër reference: DS-1237/2022 të datës 09.12.2022, ka themeluar marrëdhënie pune në kuadër të SKGJK-së, në pozitën Zyrtar Ligjor në Gjykatën Themelore në Gjakovë-Dega në Malishevë, me koeficient të pagës (7), ndërsa, pas miratimit të Rregulloren Nr. 02/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës për Nëpunësit Civile në Administratën e Sistemit Gjyqësor të njëjtit i është lëshuar Akt emërimi me numër Reference DS-534/2024 i datës 01.07.2024 për pozitën e njëjtë, me koeficient të pagës J15(5.85).

Ankuesi, më datë 10.03.2025, i është drejtuar më kërkesës SKGJK-së për kompensim të diferencës së pagës nga klasa profesional 2 në klasën profesional 1 dhe atë në mënyrë retroaktive nga muaji korrik 2023 deri maj 2024. Drejtori i Përgjithshëm i SKGJK-së, më Vendimin ref: DS-163/2025, të datës 26.03.2025, ka refuzuar kërkesën e ankuesit, me arsyetimin se SKGJ ka vepruar në pajtim më Vendimin Nr.04/128 të datës 16.02.2023, të Qeverisë së Republikës Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor.

Ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kundërshtuar ligjshmërinë e Vendimit me referencës DS-163/2025, të datës 26.03.2025, të Drejtorit të Përgjithshëm të SKGJK-së, më pretendimin se akti i kundërshtuar me ankesë është nxjerrë në kundërshtim me ligjin material, ngase Këshilli Gjyqësor i Kosovës më datës 18.01.2023, ka nxjerr Vendim për klasifikimin e vendeve të punës për të punësuar në gjyqësor ku pozita e Zyrtarit Ligjor është klasifikuar në klasën Profesional 1, Grupi J, Klasa J15, koeficienti 5.85, mirëpo, sipas ankuesit ky bendim nuk është zbatuar. Kërkon nga Këshilli që të aprovoj ankesën si të bazuar, të anulohet Vendimin e KGJK, nr.reference DS-163/2025 të datës 26.03.2025, si të kundërligjshëm, dhe të detyrohet Këshilli Gjyqësor i Kosovë të bëjë kompensimin retroaktiv të diferencës në pagë dhe atë për muajin shkurt 2023 deri muajin maj 2024 në total prej 16 muajsh, diferenca e koeficientit të bëhet në mes të kategorisë Profesional 1 me koeficient 5.85 dhe Profesional 2 me koeficient 5.30.

Kolegji i Këshillit në kuptim të bazushmerisë së pretendimeve ankimore, ri kujton fillimisht faktin e pakontestuar së Kuvendi i Republikës së Kosovës më datë 22.12.2022. ka miratuar Ligjin Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik (i zbatueshëm nga data 05.02.2023), ndërsa, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, më datë 18.01.2023, kishte nxjerrë Vendimin KGJK. nr.01/2023, për Klasifikimin e Vendeve të Punës për të Punësuarit në Gjyqësor, ku përmes pikës III, hyrja në fuqi e këtij vendimi ishte kushtëzuar më hyrjen në fuqi të Ligjit /L-196 për Pagat në Sektorin Publik. Ndërsa, më datë 06.06.2024 ka miratuar

Rregulloren Nr.02/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor.

Rrjedhimisht, Ligji bazik Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, me nenin 2, ka përcaktuar se: ''1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj. 3. Për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, ky ligj zbatohet për atë që nuk cenon pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative të garantuar me Kushtetutë'', ndërsa, më nenin 14, paragrafi 3, ka paraparë se 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik...''

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se edhe pse KGJK-ja kishte nxjerrë Vendimin GJK. nr.01/2023 të datës 18.01.2023, për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Gjyqësor, pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik procedimi i pagave sipas sistemit të ri të pagave për të gjithë të punësuarit në SKGJK-ë është bërë sipas koeficienteve të miratuar më Vendimin Nr.04/128 të datës 16.02.2023, të Qeverisë së Republikës Kosovës (lidhur me ekuivalencën e sistemit të vjetër me sistemin e ri të klasifikimit të koeficienteve me qëllim të llogaritjes së pagës bazë), e si pasojë, ankuesi duke qenë se sipas Akt Emërimit me numër protokolli 03/2203, të datës 09.12.2022, ka pas koeficient 7, atëherë e njëjti edhe ka realizuar page me koeficient 5.3, klasa profesional 2. Pra, si rezultat i zbatimit të vendimit Nr.04/128 të datës 16.02.2023, të Qeverisë së Republikës Kosovës, nuk ka mundur të zbatohet Vendimi KGJK. nr.01/2023 i datës 18.01.2023, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, sepse sipas pikës 6 të Vendimit Nr.04/128 të datës 16.02.2023, të Qeverisë së Republikës Kosovës, ky vendim ishte e detyrueshëm për të gjitha institucionet publike deri në klasifikimin e pozitave të punës nga institucionet publike.

Bazuar në praktiken kushtetuese tashme të konsoliduar (aktgjykimet KO79/23, KO219/19, KO73/16, KO171/18, me KO203/19), institucionet e sistemit të drejtësisë kanë pavarësinë e tyre të organizimit dhe të funksionimit, duke nënkuptuar të drejtën që më akt të veçantë të rregulloj organizmin dhe klasifikimin vendeve të punës për të punësuarit në këto institucione, atëherë, në reference të kësaj pavarësie Këshilli Gjyqësor i Kosovës më datë 06.06.2024 ka miratuar Rregulloren Nr. 02/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës për Nëpunësit Civile në Administratën e Sistemit Gjyqësor, ku pozita e ankuesit ishte klasifikuar në klasën profesional 1, Grupi J, Klasa e pagës J15, koeficienti 5.85, ashtu që, ankuesi që nga data 01.07.2024, realizon pagë në pajtim me kategorinë dhe klasën e pagës të përcaktuar më këtë rregullore.

Nisur nga theksimet si më sipër, Kolegji vlerëson se nuk gjejnë mbështetje pretendimet ankimore të ankuesit për kompensim të diferencës së koeficientit të pagës nga klasa profesional 2 më koeficienti 5.3, në klasën profesional 1, më koeficientin 5.85, dhe atë për periudhën korrik 2023 deri maj 2024, pasi që sikurse u tha më lartë, Vendimi KGJK. nr.01/2023 i datës 18.01.2023 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nuk ka mundur të zbatohet për shkak të rrethanave juridike të krijuara pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Pagat në Sektorin Publik, andaj edhe mbi këtë bazë, Kolegji vlerëson se vendimi i kontestuar është i ligjshëm.

Thënë si më sipër e në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 132, paragrafi 2 të LPPA-së, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.675/2025

Kaltrina Avdullahi Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, E.K;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në SKGJK; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.